

OSHEE GROUP sh.a njofton mbi hapjen e vendit vakant **Shef Sektori** pranë OSSH / Departamenti i Kontrollit dhe Rekuperimit të Humbjeve / Drejtoria e Kontrollit dhe Analizës / Sektori i Kontrollit dhe Rekuperimit të Humbjeve.

SHEF SEKTORI

Shefi i Sektorit të Kontrollit dhe Rikuperimit të Humbjeve është përgjegjës për organizimin, drejtimin dhe mbikëqyrjen e proceseve operative që lidhen me identifikimin në terren, verifikimin, hetimin dhe rikuperimin e humbjeve të energjisë elektrike, me synim reduktimin e humbjeve teknike dhe jo-teknike, rritjen e arkëtimeve dhe garantimin e zbatimit të kuadrit ligjor dhe procedural.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Planifikon, organizon dhe ndjek aktivitetet e kontrollit dhe rikuperimit të humbjeve.
- Koordinon punën e stafit të sektorit dhe siguron shpërndarjen efikase të detyrave.
- Siguron zbatimin e procedurave, rregulloreve dhe legjislacionit në fuqi.
- Mbikëqyr procesin e kontrollit për identifikimin e rasteve të humbjeve të energjisë, përfshirë vjedhjen e energjisë dhe parregullsitë teknike.
- Ndjek dhe koordinon hetimin e rasteve të dyshimta në bashkëpunim me strukturat përkatëse.
- Siguron dokumentimin korrekt të rasteve dhe ndjekjen e tyre deri në përfundim.
- Organizon dhe ndjek procesin e rikuperimit të humbjeve të konstatuara, në përputhje me aktet ligjore dhe procedurat e brendshme.
- Monitoron realizimin e masave të rikuperimit dhe propozon masa për rritjen e efikasitetit.
- Analizon pengesat operative dhe propozon zgjidhje praktike.
- Bashkëpunon ngushtë me Sektorin e Raportimit dhe Analizës për shkëmbimin e të dhënave dhe prioritizimin e kontrolleve.
- Koordinon veprimet me departamente të tjera (juridik, IT, shërbime teknike, etj.).
- Përgatit raporte periodike mbi aktivitetin e kontrollit dhe rikuperimit.
- Raporton mbi rezultatet, problematikat dhe nevojat për ndërhyrje strukturore.
- Detyra të tjera, të ngarkuara nga Eprori i drejtpërdrejtë.

Kualifikimet dhe kërkesat:

- Arsim i lartë në inxhinieri, ekonomi, informatikë, statistikë ose fusha të ngjashme.
- Jo më pak se 3 vite eksperiencë pune në menaxhim, kontroll, analizë ose sektorin energjetik.
- Aftësi të forta analitike, organizative dhe drejtuese.
- Njohuri mbi analiza të të dhënave, raportim dhe përdorimin e sistemeve analitike.
- Aftësi shumë të mira komunikimi dhe bashkëpunimi ndërsektorial.

Të gjithë kandidatët e interesuar janë të lutur të bëjnë aplikimin në websiten e OSHEE group, në portalin e punësimit.

Ju njoftojmë se vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë.